

VENDIM
Nr.628, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 413, DATË 26.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS, SI DHE TË
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AUTORITETIT
TË AVIACIONIT CIVIL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.10233, datë 11.7.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.413, datë 26.5.2010, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.3 është sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

““Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët”, në Autoritetin e Aviacionit Civil, që punojnë në pozicione punë që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AUTORITETIN E
AVIACIONIT CIVIL

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	

			(SHV)			
Titullar i institucionit	II-a	1	2%		105 000	15 000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	1	2%		88 000	15 000
Drejtor drejtorie	II-b	1	2%		88 000	0
Përgjegjës sektori Inspektor auditi	III-a	1	2%		71 000	0
Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%		62 000	0
Inspektor Specialist	III-b	1 ose 2	2%		54 000	0
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000	0

Lidhja nr.5

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë